

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 14, paragrafi (1) dhe neni 29, paragrafi (2) të Ligjit për Median ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13 dhe 13/14 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.63/24, 74/24, 218/24 dhe 87/25), pika 3, nënparagrafi 2 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.03-778/1 datë 27.2.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026, në pajtim me Konkluzionin nr. 02-1838/3 datë 27.4.2026 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria për shërbime informacioni, teknike dhe konsulencë (ShShITK) DMS KOMUNIKACIJA ShPKNJ P Shkup, botues i medias online – internet portalit "Skopje Info" (www.skopjeinfo.mk), për shkeljen e kryer të nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Mediat, në mënyrë që në impresiumin në "Skopje Info" (www.skopjeinfo.mk) nuk ka publikuar të dhënat për: emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias dhe emrin e mbiemrin e redaktorit përgjegjës përkatësisht redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë.

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.03-778/1 datë 27.2.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr. 1.

2. URDHËROHET që Shoqëria për shërbime informacioni, teknike dhe konsulencë DMC KOMUNIKACIJA ShPKNJ P Shkup, botues i medias online – internet portalit "Skopje Info" (www.skopjeinfo.mk) në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia), në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Median (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet sipas neneve 6, 8, 14 dhe 15 të LM-së.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias ndërmerr masë - paralajmërim publik në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje të dispozitave të LShMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29, paragrafi (2) të LM-së, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent, mund t'i ndërmarrë, dhe që janë të përcaktuara në EShMAAV, përkatësisht do të zbatohen dhe në rast të shkeljes së LM.

Sipas nenit 14, paragrafi (1) të LM-së, botues i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartje në veçanti të përmbajtjes (për shembull, kopje të medias së shtypit, emision televiziv dhe në pjesën për impresium të medias online – internet portalit) të siguroj publik të të dhënave në vijim: emrin dhe adresë të selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emër të personit përgjegjës të botuesi të medias, emër dhe mbiemër të redaktorit përgjegjës, përkatësisht redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin e adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose të ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur është medium i shtypit.

Agjencia në kuadër të kompetencave ligjore, përmes Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, më 27 shkurt 2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative të subjektit të mbikëqyrjes, ShShITK DMS KOMUNIKACIJA ShPKNJ P Shkup, botues i medias online – internet portalit "Skopje Info" (www.skopjeinfo.mk), ku është konstatuar se nuk ka përmbushur plotësisht detyrimin e nenit 14, paragrafi (1) të LM, në mënyrë që në impresium të "Skopje Info" (www.skopjeinfo.mk) nuk ka publikuar të dhënat për: emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias dhe emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës, redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.03-778/1 datë 27.2.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar ShShITK DMS KOMUNIKACIJA ShPKNJ P Shkup më 4/3.2026, dërgoi Shkresë PA1 nr.03-778/2 datë 4.3.2026, me të cilën dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.03-778/1 datë 27.2.2026, me qëllim që në aft prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresë u pranua në mënyrë të rregullt nga ShShITK KOMUNIKACIJA ShPKNJ P Shkup, më 10.3.2026, për të cilën në afatin e parashikuar nuk paraqiti deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM-së. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 27.4.2026, pasi shqyrtoi Raportin me shkrim, konkludoi që ShShITK DMS KOMUNIKACIJA ShPKNJ P Shkup t'i shqiptoi masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, dhe në lidhje me nenin 14, paragrafi (1) dhe neni 29, paragrafi (2) të LM-së, pika 3, nënparagrafi 2 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës dhe Raportit me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark. 03 - 778/1 datë 27.2.2026, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM-së, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-1838/11 datë 27.4.2026, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron ShShITK DMS KOMUNIKACIJA ShPKNJ P Shkup, botuesi i medias online – internet portalit "Skopje Info" (www.skopjeinfo.mk) dhe urdhërohet në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM-së. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24, paragrafët (1) dhe (2) të LShMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi botuesi i medias online – internet portalit ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit..

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.03-778/1 datë 27.2.2026.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, botuesi i medias online – internet portalit ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antonea Shabani